



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:043238
Datë: 04.02.2025
Numri i dokumentit: 06803307

C.nr.725/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – **Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, me gjyqtarin Baki Shigjeqi , duke vendosur në çështjen juridiko- kontestimore të paditësve N.U. me numër personal me vendbanim në fshatin Komuna e Prizrenit, A.Q. me numër personal me vendbanim në fshatin Komuna e Prizrenit dhe A.D. me numër personal me vendbanim në Prizren, të cilët me autorizim i përfaqëson av. S.M. nga Prizrenit, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e shujtave ditore dhe kualifikimit -licencimit, vlera e kontestit 4,286.21 euro, jashtë seance, me datë 04.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve N.U., A.Q. dhe A.D. kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e shujtave ditore dhe kualifikimit ose licencimit. **DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditësve në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e shujtave ditore dhe kualifikimit -licencimit, ti paguaj paditësve shumat si në vijim:

- Paditëses N.U. në emër të kualifikimit –licencimit për periudhën kohore prej datës 03.08.2021 deri më datë 06.02.2023 apo për 18 muaj e 4 ditë (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, si dhe për 4 ditë shumën prej 7.38 euro) në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit t’ia paguajë shumën prej **1,003.68 euro**;
- Paditësit A.Q. në emër të kualifikimit –licencimit për periudhën kohore prej datës 31.06.2021 deri më datë 06.02.2023 apo për 19 muaj e 7 ditë (për çdo muaj shumën prej 89.03 euro, në shkallë prej 35 % të pagës bazë - 421 euro, si dhe për 7 ditë shumën prej 20.77 euro) në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit t’ia paguajë shumën prej **1,712.34 euro**,

- Padiësës A.D. në emër të shujtave ditore për 99 ditë pune (nga data 26.10.2020 deri më datën 18.04.2021, nga 2 (dy) euro në ditë), shumë prej 198.00 euro. Në emër të kualifikimit –licencimit për periudhën kohore prej datës 19.11.2021 deri më datë 06.02.2023 apo për 14 muaj e 18 ditë (për çdo muaj shumë prej 83.01 euro, në shkallë prej 35 % të pagës bazë – 393.00 euro, si dhe për 18 ditë shumë prej 49.86 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit t’ia paguajë shumë prej 1,213.26 euro), e në shumë të përgjithshme prej **1,411.26 euro**;

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, për secilin paditës e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë më datë 03.03.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

- II. REFUZHET** e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, përtej shumë së gjykuar si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimit, dhe atë për paditësen N.U. në shumë prej 72.18 euro, paditësit A.Q. në shumë prej 77.46 euro dhe paditësen A.D. në shumë prej 6.28 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 155.92 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, mbi pagën bazë të kërkuar.
- III. DETYROHET** e paditura, që paditësve, t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 228.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit N.U., A.Q. dhe A.D. të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av.S.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 03.03.2022 kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komonale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën shujtave ditore dhe kualifikimit -licencimit, vlera e kontestit 4,286.21 euro.

Fillimisht i autorizuari i paditësve në padi ka theksuar, se paditësi A.Q. është i punësuar pranë SHFMU “Luigj Gurakuqi” në fshatin Nashecë, Komuna e Prizrenit, ndërsa paditësës N.U. dhe A.D. janë të punësuar pranë SHFMU “Atmaxha” në fshatin Atmagjë, Komuna e Prizrenit, dhe se bazuar në nenin 35 par 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi më 18.04.2017, paditësës A.D. i takon e drejta e kompensit të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë dhe atë 2 euro në ditë për çdo ditë pune për periudhën 02.11.2020 deri me datë 18.04.2021, për 300 ditë punë në shumë prej 600 euro. Ndërsa të gjithë paditësve duke u bazuar në nenin 7 pika 1.1 të KKA të vitit 2021, ju takon e drejta e realizimit të kompensimit mbi bazën e kualifikimit –licencimit dhe atë në 10% të pagës mujore. Edhe përkundër se paditësit me kërkesë i janë drejtuar të paditurës për pagesë të këtyre mjeteve, e

paditura në afat ligjorë nuk ka dhënë përgjigje, andaj paditësit janë drejtuar që përmes kësaj padie të kërkojnë realizimin e të drejtave të tyre.

I autorizuari i paditësve, përmes parashtresës së datës 25.10.2023 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, duke kërkuar që paditëses A.D. t'i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e shujtave ditore për periudhën 26.10.2020 deri me datë 18.04.2021, në shumën prej 198.00 euro. Ka shtuar se paditësve me vendimin Nr.01/33 të datës 29.08.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i cili ka qenë në fuqi deri me datë 06.02.2023, ju takon e drejta e kompensimit për 27% dhe 35% të vlerës së pagës bazë për kualifikim-licencim, bazuar në nivelin e gradës së shkollimit, dhe atë paditëses N.U. për periudhën 03.08.2021 deri me 06.02.2023 për 18 muaj në 27% të pagës bazë i takon shuma e kompensimit prej 1,075.86 euro, paditësit A.Q. për periudhën 31.06.2021 deri me 06.02.2023 për 19 muaj në 35% të pagës bazë i takon shuma e kompensimit prej 1,789.80 euro dhe paditëses A.D. për periudhën 19.11.2021 deri me 06.02.2023 për 14 muaj në 35% të pagës bazë i takon shuma e kompensimit prej 1,219.54 euro. Andaj, ka propozuar që të aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditëses, të detyrohet e paditura t'ia kompensojë shumën e lartcekura për secilin paditës në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën shujtave ditore dhe kualifikimit -licencimit, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën e përgjithshme prej 457.00 euro.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësve se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 353 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, duke deklaruar se paditësit kanë humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që ka kaluar afati 3 vjeçar, andaj i tërë viti 2017 e deri më 23.04.2021, konsiderohet si e drejtë e parashkruar. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit N.U.dhe A.D. janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si punëtorë pranë SHFMU “17 Shkurti”, ish “Armaxha”, në fshatin Atmaxhë, Komuna e Prizrenit, ndërsa paditësi A.Q. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si punëtorë pranë SHFMU “Luigj Gurakuqi”, në fshatin Nashec, Komuna e Prizrenit. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve u takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga

marrëdhënia e punës mbi bazën e shujtave ditore dhe kualifikimit -licencimit, si dhe nëse kërkesa e paditësve për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës për periudhën 2017 deri me datë 23.04.2021 është parashkruar.

Gjykata përmes kontratës së punës me nr. 1 e datës 18.12.2018, gjykata vërtetoi faktin se paditësja N.U. është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 1140, e datës 21.12.2017, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit – Qendra në Prizren, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i programit fillor. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë e paditëses është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Nga Kontrata e punës me numër të protokollit 59/2019 e datës 02.09.2019, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.Q. është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 966 e datës 19.02.2018, e lëshuar nga Universiteti i Tetovës, në emër të paditësit, ku i njëjti ka marrë titullin magjistër i matematikës, e cila diplomë i është njohur me vendimin ref.nr.6-1418 të datës 29.05.2018 lëshuar nga Ministria e Arsimit. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Gjykata përmes kontratës së punës me nr. 109/20 të datës 02.11.2020 dhe 98/21 e datës 27.09.2021, vërtetimit me nr. të protokollit 9/22 i datës 03/03/2022 i lëshuar nga drejtori SHFMU “17 Shkurti” në fshatin Atmagjë, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Afrodita Drini është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, për periudhën kualifikimi 26.10.2020 deri me datë 18.04.2021 ka pasur 99 ditë pune. Paditësja është me kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e gjuhëve , kulturave dhe komunikimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 1011-1336/1 e datës 09.05.2018, e lëshuar nga Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin magjistër në menaxhimin dhe udhëheqjen në arsim. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë e paditëses është në shumë prej 393.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 54.45 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen për kresat sa i përket shujtave ditore gjen zbatim nenin 35 par.7, të KKAQ-së nr.prot. Nr. 01B/2056 e datës 18.04.2017 ku është paraparë se “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro

për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...” si dhe neni 35 par.7, të KKAk-së nr.prot. Nr. 01B/ 105 e datës 22.01.2021 është paraparë se “Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për u shqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”, ndërsa neni 45 thuhet se “Nëse nga Kontrata Kolektive pasi t’i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i sajë vazhdon edhe për një vitë”. Në bazë të dy neneve të kontratave kolektive të arsimit në Kosovë mbulohet periudha e kërkesës së paditëses prej 26.10.2020 deri 18.04.2021. Ndërsa sa i përket kërkesë për kompensimi mbi bazë e kualifikimit-licencimit në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditësve, t’ia paguaj kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, me nr. Nr. 01B/2056 e datës 18.04.2017, dhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e datës 22.01.2021, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht, paditësja A.D. për 99 ditë pune, t’ia paguaj shumën nga 198 euro. Ndërsa sa i përket kërkesë për kompensimi mbi bazë e kualifikimit-licencimit, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësve t’ia bëjë kompensimin, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetimeve dhe kontratave të punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditësve N.U. dhe A.Q. ia ka paguar shumën prej 58.32 euro, për çdo muaj, ndërsa paditësja A.D. ia ka paguar shumën prej 54.45 euro, për çdo muaj. Sipas pikës 4 nën pikës 2 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësit A.Q. dhe A.D. përfitojnë ngritje prej 35% të pagës bazë për shkake të gradës magjistër-master, ndërsa paditësja N.U.përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë për shkak të gradës bachelor.

Gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësja N.U. për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro, apo diferencën e mbetur për 18 muaj e 4 ditë, nga data 03.08.2021 e deri më datë 06.02.2023, në shumë të përgjithshme prej **1,003.68 euro** ($18 \times 55.35 = 996.30$) si dhe periudha 4 ditë shumën prej 7.38 sipas ($55.35/30 = 1.845 \times 4 \text{ ditë} = 7.38$) pra $996.30 + 7.38 = 1,003.68$ euro.

Paditësit A.Q. për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 89.03 euro, apo diferencën e mbetur për 19 muaj e 6 ditë, nga data 31.06.2021 e deri më datë 06.02.2023, në shumë të përgjithshme prej **1,712.34 euro** ($19 \cdot 89.03 = 1,691.57$) si dhe periudha 7 ditë shumën prej 20.77 euro sipas ($89.03/30 = 2.96 \cdot 7 \text{ ditë} = 20.77$), pra $1,691.57 + 20.77 = 1,712.34$ euro.

Për paditësen A.D. për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 83.10 euro, apo diferencën e mbetur për 14 muaj e 18 ditë, nga data 19.11.2021 e deri më datë 06.02.2023, në shumë të përgjithshme prej **1,213.26 euro** ($14 \cdot 83.10 = 1,163.40$) si dhe periudha 18 ditë është 23.37 sipas ($83.10/30 = 2.77 \cdot 18 \text{ ditë} = 49.86$), pra $1,163.40 + 49.86 = 1,213.26$ euro, si dhe në emër të shujtave ditore për 99 ditë shumën prej 198.00 euro, e në shumë të përgjithshme prej **1,411.26 euro**.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*. Gjkata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia njohur paditësve kompensimin mbi bazën kualifikimit në pagën bazë të cilën e realizojnë paditësit dhe atë në shumën prej 421.00 euro për paditësit N.U. dhe A.Q. dhe në shumën prej 393 për paditësen A.D. duke u bazuar në listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe vërtetime të lëshuar nga drejtori i shkollës. Andaj, mbi këtë bazë, gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditësve sikurse në pikën nën II. të dispozitivit të aktgjykimit, dhe atë për paditësen N.U. kërkesën në shumën prej 72.18 euro, paditësit A.Q. kërkesën në shumën prej 77.46 euro dhe paditësen A.D. kërkesën në shumën prej 6.28 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 155.92 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, mbi pagën bazë të kërkuar.

Gjkata nuk i vlerësoj të pabazuara pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesë nga viti 2017 deri me datën 23.04.2021, ngase me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 03.03.2022 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.03.2019 e deri më 06.02.2023. Gjkata konstaton se parashkrim për kërkesën e paditësve për vitin 2021 deri me datë 06.02.2023 nuk është arritur, pasi në bazë të nenit 342 të LMD-së, ku parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*, pra nuk kanë kaluar 3 vite nga paraqitja e padisë, pra padia është paraqitur brenda këtij afati dhe se paditësve ju takon kjo e drejtë. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësës sikurse në pikën nën I-të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën II të dispozitivit të aktgjykimit, për shkak se paditësit e kanë kërkuar kompensimin e kualifikimit mbi pagën bazë të cilën e realizojnë.

Gjkata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 03.03.2022, bazuar në Mendimin Juridik për

Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 228.00 euro, sipas kërkesës së palës paditëse, për përpilimin e padisë shumën prej 208.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar për precizim të padisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:043238, 04.02.2025

G j y q t a r i

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.